

Një informacion për prindër

Të rinjët mysliman në Zvicër mësojnë një profesion

Çfarë qellimi ka ky fletëudhëzim?

Rreth 70% të të rinjëve në Zvicër pas shkollimit të obliguar mësojnë një profesion. Ata bëjnë një mësim bazë profesio-nal. Mirëpo përvoja tregon se të rinjët e huajë posaçërisht ata mysliman, pas shkollimit të obliguar mbesin pa profesion për ndryshim nga të rinjët zvicëran, janë raste të rralla kur ata bëjnë një shkollim të mesëm. Nga kjo rrjedh se ata nuk kanë kualifikim për ndonjë punë. Ky fletëudhëzim donë të tregon se të rinjët mysliman shumë lirshëm mund të integrohen në tregun zvicëran të punës, nëse ndërmarrjet dhe prindërit janë të hapur dhe fleksibil.

Kujt i drejtohet ky fletëudhëzim?

Ky fletëudhëzim u drejtohet prindërve të të rinjëve mysliman. Është një bashkëpunim me Këshillimoren për profesione dhe me personat kompetent mysliman, përfaqësues të bashkësis islame.



Jeta dhe arsimimi në Zvicër

Shkolla dhe mësimi profesional në Zvicër janë shumë të rëndësishme dhe thelbësore. Kështu duhet të jetë edhe për mysliman. Sa më shumë që njeriu të dijë aq më mirë do ta gjen veten, dhe po aq më mirë do të dijë ta drejtoj veten. Njohja e gjuhës për këtë është thelbësore.

Çka është një mësim profesional bazë?

Mësimi profesional bazë është një mësim në ndonjë ndërmarrje si psh. ato të industris, tregëtis, bujqësis, profesione-ve sociale dhe edukative. Kjo zgjatë 3-4 vite. Egzistojnë poashtu shkolla 2 veçare për të rinjët që kryesisht kanë vështirsi në mësim, apo vështirsi gjuhësore. Në mësimin bazë profesional të rinjët kryesisht mësimin praktik e bëjnë në një ndërmarrje, kurse atë teo-rik e bëjnë në shkollat profesionale. Pas përfundimit të shkollimit profesional njeriu mund të gjej punë në profesion. Mësimi bazë profesional është një bazë e mirë dhe hapë rrugë të ndryshme. Njeriu mund të mësojë dhe një profesion të dytë, të specializohet, të shkollohet tutje dhe kështu mund të bëhet udhëheqës/e etj. Ata të cilët janë më të aftë mund ta bëjnë maturën në profesion dhe kështu mund të bëjnë një shkollë të lart, apo me një vitë plotësus parapëga-ditor për të studiuar në Universitet. Një gjë është e vertet: Tregu i punës po ndryshon. Nuk mjafton më të mësosh një profesion. Njeriu duhet të përcjellë dhe mësojë risitë në profesion.

Si zgjedhet një profesion?

Në Zvicër mund të mësohen më se 250 profesione. Kryesisht ka profesione praktike të cilat kërkojnë njohuri shumë të mirë të gjuhës dhe matematikës. Profesionit duhet t'ju përgjigjet të rinjëve apo të rejave. Nga kjo rrjedh se zgjedhja e profesionit është shumë e rëndësishme dhe kërkon shumë. Prindërit dhe të rinjët duhet domosdo që me kohë të informohen mbi mundësit e shkollimit (kjo do të thotë normalisht nga klasa e 8) mbi kërkesat dhe mundësit e gjetjes së një vendmësimi (Lehrstelle). Kështu që ata mund të vendosin më mirë dhe të dijnë se ku mund të kërkojnë ndihmë.

Ku mund të mirren informata dhe këshalla?

Të rinjët dhe prindërit mund të informohen në tubime informarive dhe për këtë është e domosdoshme pjesëmarrja e të rinjëve dhe prindërve. Pos kësaj Këshillimoret për profesione ofrojnë një mori broshurash mbi profesione, si dhe adre-sa të ndërmarrjeve dhe shkollave. Tek paqartësit dhe pytjet lidhur me zgjedhjen e profesionit është e nevojshme që të bëni një takim për një këshillim personal në këshillimore. Adresat e këshillimoreve për profesione mund të merren në shkollë apo komunë.

Çdo kanton ka së paku një Këshillimore për profesione: www.berufsberatung.ch > BIZ. Këto vende shpesh herë njihen më mirë në bazë të shkurtesave: Në pjesën gjermanofolse në Zvicër BIZ. Në pjesën frankofone në Zvicër OP, OSP, OCOSP.

Pse është një arsimim i domosdoshëm pas shkollimit të obliguar?

Pa një arsimim nuk ka punë të paguar mirë. Ndhimëspuntorë/e në Zvicër kërkohen gjithnjë e më pakë. Pa-punësia në Zvicër është duke u rritur. Sa më i dobët është arsimimi aq më veshtirë është gjetja e një vendi të punës. Poashtu edhe vajzat duhet ta bëjnë një arsimim, që më vonë mundësisht të jenë pjesëmarrse në të ardhura familjare. Në një familje me fëmijë, sotë në Zvicër është shpesh e nevojshme që të punojnë të dy prindërit. Pos kësaj sipas të drejtës zvicerane nuk është vetëm burri përfundimisht përgjegjës për mbajtjen e familjës.

A janë vajzat e rrezikuara nëse ato mësojnë profesionin në një ndërmarrje?

Ligjet zviceriane i mbrojnë gratë dhe burrat nga vardisjet seksuale në vëndin e punës. Punëdhënësit janë të obliguar t'ju përmbahen këtyre ligjeve.

A mund tu përmbahemi rregullave të të ushqyerit islam?

Të shumtën e rasteve mësimi bëhet në ndërmarrje të vogla apo të mesme, ku shpesh ato nuk kanë mensë. Të rinjët mund ta marrin dreken nga shtëpia. Në mensat e ndërmarrjeve të mëdha sotë ka shpesh ushqime vegetare, kështu që rregullave të të ushqyerit mund tu përmbahen pa problemë. Askush nuk obligohet të pijë alkohol...Mirëpo një gjë duhet ditur: Për një mësim si kuzhinjer-kuzhinjere duhet përgaditur edhe mish derri edhe pse vet nuk duhet ta hani. Kurse në shkollimin për kamarier duhet t'ju sherbejn atyre mysafirve të cilët konsumojnë alkohol. Mirë-po pas përfundimit të shkollimit egzistojnë mundësitë të punohet në vende ku nuk ofrohet mish derri, apo ku nuk sherbet alkoholi.

A mund të shkollohet një femer e cila mban shamin?

Parimisht një femer e mbuluar mund të apsolvoj një mësim profesional. Kjo mvaret edhe nga punëdhënësi. Shumë njerëz ndihen të irituar nga shamia. Në disa ndërmarrje (si psh. Bankat) dhe në disa vende të caktuara të punës (në sportel) egzistojnë rregulla të të veshurit, të cilat deri më sotë e kanë pamundësuar mbajtjen e shamisë në kokë. Prindërit dhe vajzat për këtë duhet të mëndojnë, çka për ta është më me rëndësi. Gjithësesi një femer e mbuluar e ka më veshtirë ta gjejë një vëndmësim në një ndërmarrje se sa një femer tjetër. Një punëdhënës/e është plotësisht i lirë ta punësojë atë që ai dëshiron. Nëse një vajzë dëshiron ta mbajë shamin, këtë duhet ta sqarojë mirë në takimin prezentues.

Arsimimi në lamitë e shëndetësis

Përpara edhe në spitale në Zvicër ka egzistuar përkujdesja në bazë të gjinive, ku gratë janë përkujdesur për gratë. Sotë kjo nuk ekziston më. Pas përfundimit të mësimit në shëndetësi ka mundësi që femrat të punojnë në spitalin e grave, ose në një repart të gjinekologjis. Pas kësaj ekzistojnë specializime dhe mundësi të shkollimit të mëtejshëm në profesionet shëndetëore (labor, mami) në profesione sociale dhe ekonomi shtëpiake.

Udhëtimi për në shkollë - punë

S'mund gjithmonë të ndysohet se prej vendbanimit deri tek vendmësimi apo te shkolla për profesione duhet bërë një rrugë të gjatë. Vërtet në shoqërit tradicionale islame nuk është e lakmusheme që vajzat dhe gratë të bëjnë një rrugë të gjatë pa shoqërimin e të afërmeve. Këto masa aplikohen vetëm për atë që vajzat dhe gratë të mbrohen nga rreziqet dhe kursesi që atyre t'ju kufizohet liria e levizjes. Atje ku kjo siguri ekziston, e kjo në raste të shumta ekziston në Zvicër, mund të hiqet dorë nga ky shoqërim.

Shumica e fëmijëve të familjeve të ardhura – poashtu edhe ata mysliman – do të mbesin në Zvicër. Nëse ata deshirojnë të jenë të sukseshëm, duhet të mësojnë, kulturën dhe identitetin e tyre fetar ta vejnë në harmoni me kushtet e jetës dhe punës në Zvicër.

www.berufsberatung.ch/migration
www.orientation.ch/migration

Deutsch: Muslimische Jugendliche lernen in der Schweiz einen Beruf, s. www.be.ch/biz-dokumente

Français: Des jeunes musulmans et des jeunes musulmanes apprennent un métier en Suisse, voir sous www.be.ch/op-documents